

TAKIMI I DYTË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **08.11.2023**.

Feedback lidhur me vizitën studimore në Estoni

Mbledhja u hap me diskutimin e rezultateve të vizitës studimore të kryer nga anëtarët e Komitetit dhe Sekretariati Teknik në Estoni. Sekretariati Teknik informoi se, delegacioni kishte pasur mundësinë të vizitonte disa shkolla dhe institucione përgjegjëse për çështjet e kurrikulës së IT-së. Anëtarët evidentuan se, nga vizita kishin kuptuar që në Estoni, Komiteti Sektorial ishte entiteti përgjegjës për dhënien e miratimit përfundimtar të ndryshimeve apo nevojave që lindin si kërkesë e tregut privat. Anëtarët evidentuan gjithashtu se, në Estoni kishte një lidhje të fortë dhe të qëndrueshme mes shkollave dhe sektorit privat. Gjithashtu, anëtarët evidentuan se një praktikë e mirë në Estoni, ishte mësuesit që vinin nga industria, ndërkohë që në vendin tonë kjo përbënte një problem, pasi mësuesit shpesh nuk ishin të përditësuar me ndryshimet e tregut.

Po ashtu, anëtarët theksuan se, në Estoni ndryshimet në kurrikula inicioheshin nga biznesi apo nga kërkesa të caktuara të grupeve të interesit. Anëtarët përmendën se, Komiteti Sektorial funksiononte si një rregullator i mirë në çështjet e kurrikulës dhe gjeneronte statistika, të cilat shërbenin si bazë e rëndësishme për ndjekjen e ecurisë.

Sekretariati përmendi se gjatë vizitës në Estoni, delegacioni kishte zhvilluar një takim me Konsullin e Shqipërisë në Estoni, i cili mundësoi takime me shoqata të ndryshme, duke hapur mundësinë e një bashkëpunimi të vazhdueshëm, si dhe një takim me shoqatën analoge, e cila rezultoi mjaft aktive në të gjitha nivelet, si në bashkëpunimin me shkollat ashtu edhe në çështjet e kurrikulës. Vizita të tilla u vlerësuan si mjaft të vlefshme për anëtarët e Komitetit dhe Sekretariatit.

Diskutim mbi rregulloren e funksionimit të KS

Në vijim të agjendës, anëtarët u prezantuan shkurtimisht me ndryshimet që kishte pësuar rregullorja e miratuar për funksionimin e KS, referuar draft-it të prezantuar në fillim të punës së Komitetit. Çështja që u diskutua kishte të bënte me numrin e takimeve që mund të zhvillonte Komiteti, i përcaktuar në rregullore jo më shumë se katër takime. Anëtarët diskutuan se, në rast nevojë, takimet shpesh mund të zhvilloheshin online ose fizike të papaguara.

Zgjedhja e kryetarit të ri

Anëtarët u njoftuan se, kryetarja e Komitetit Sektorial kishte kërkuar dorëheqjen për shkak të disa problematikave shëndetësore që e pengonin në angazhimin e plotë për realizimin e detyrës. Në këtë situatë, anëtarët duhej të propozonin, votonin dhe zgjidhnin kryetarin e ri të Komitetit. U sugjerua që, nisur nga rëndësia e Komitetit për angazhimin e biznesit, kryetari të ishte përfaqësues i biznesit. Propozimi u hodh në votim dhe anëtarët e pranishëm miratuan njëzëri.

Prezantimi i kritereve të validimit të standardit të profesionit

Në vijim të pikave të agjendës, Sekretariati prezantoi kriteret e validimit të standardeve të profesioneve. Sekretariati shpjegoi formatin dhe përmbajtjen e një standardi, mënyrën e hartimit dhe rëndësinë e validimit nga Komiteti Sektorial.

Validimi i standardit të profesionit “*Teknik të inxhinierisë software-ike*”

Pas prezantimit të kriterëve të validimit, anëtarët u njohën me standardin e profesionit “*Teknik të inxhinierisë software-ike*”. Sekretariati prezantoi çdo funksion dhe detyrë të përcaktuar në standard nga grupi hartues. Komiteti Sektorial diskutoi të gjitha funksionet dhe detyrat dhe zhvilloi një sërë diskutimesh për përcaktimin final të funksioneve dhe detyrave të përshtatshme për këtë profesion. Të gjitha ndryshimet dhe rekomandimet u pasqyruan në draft-in final të standardit.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët u njoftuan se, brenda muajit dhjetor do të zhvillohej takimi i radhës i Komitetit Sektorial, në të cilin do të bëhej validimi i standardit të profesionit “*Specialist i sigurisë kibernetike*”, i cili ishte në proces hartimi nga grupi i punës.

Vendime të marra nga mbledhja:

- Vizita në Estoni ishte me shumë vlerë për Komitetin Sektorial.
- U zgjodh kryetari i ri i Komitetit Sektorial.
- U validua standardi i profesionit: “*Teknik i inxhinierisë software-ike*”.